

FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomikë)

Albania Distribution Chemicals

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

M11815028I

NUIS/NIPT

Rruga e Kavajës, Buka SH.A, Nr.8240, Njësia Nr.6.

Adresa

Tiranë

Albania

1001

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Posta

0694000260

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

info@adchem.al

E-mail

Administrator Mamica Jançe

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

2023/09/08

Data (viti/muaji/dita)

0694000260

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

Seksioni II: Informacion mbi procedurën

Numri i referencës së procedurës/Lotit

Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentin e tenderit.

REF-78867-09-01-2023

Tipi i procedurës për ankesën

Procedure Prokurimi Publik

Tipi i ankesës

Dokumenta Tenderi

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur

Open Simple

Autoriteti/Enti Kontraktor

Emri i autoritetit/entit kontraktor që administron procesin e prokurimit.

Ujesjelles-Kanalizime Kamez Sh.a

Vlera e përllogaritur e prokurimit

Vlera e përllogaritur e kontratës/Marrëveshjes Kuadër (shuma në shifra dhe fjalë)

3348000

Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

Përshkrimi i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuadër.

Blerje Klori

Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

Data (viti/muaji/dita)

2023/09/14

Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme)

Data e nënshkrimit të kontratës

(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmëri të kontratës)

Tipi i kontratës

Data e zhvillimit të procedurës

Mallra

2023/09/14

Numri i njoftimit

Kodi CPV

24311900-624312220-2

24311900-624312220-2

Ankese mbi argument në KPP

Seksioni III: Përshkrimi i ankesës

1. Baza ligjore

(Shkelje/arsyetime ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

Baza ligjore (Shkelje ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

Ligji nr.162/2020, date 23.12.2020, “Per Prokurimin Publik”

Vendim nr.914 date 29.12.2014 te Keshillit te Ministrave “Per miratimin e rregullave te Prokurimit Publik”, i ndryshuar me vendim nr.402, date 13.05.2015, me vendim nr.823, date 23.11.2016, me vendim nr.797, date 29.12.2017 dhe me vendim nr.80, date 14.02.2018 dhe me vendim nr.823, date 21.10.2020

Neni 2

Qëllimi

Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
 - b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
 - c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
 - ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
 - d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
 - dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.
-

2. Objekti i ankesës

- Modifikim i dokumentave të tenderit

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate

(Citoni kontratën për të cilën kërkoni pavlefshmërinë)

- Tjetër

(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)

3. Rrethanat dhe faktet □

Përshkruani rrethanat e faktit. □

Brenda afatit ligjor të parashikuar në Nenin 110, Nenin 111, të LPP, duam të paraqesim këtë ankesë përpara Autoritetit Kontaktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me skualifikimin e bërë nga ana e Autoritetit Kontraktor për Operatorin të Ekonomik.

1. Operatori ekonomik ankimes dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik.

Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

Bazuar në dispozitën ligjore të mesipërme, brenda afateve të përcaktuara nga neni i mesipërme, ne ju paraqesim ankesën e mëposhtme.

Ne si Operator Ekonomik me datë 04.09.2023 mërzim dhe nepermjet sistemit elektronik hedhim e procedurës me objekt 'Blerje Klor' nga AK 'SH.A Ujesjelele Kanalizime Kamez'. Ne vijim po paraqisim argumentat tona për modifikimin e kriterëve dhe vendimet e dhëna nga ana juaj po për të njëjtin objekt prokurimi.

Neni 2

Qëllimi

Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.

Arsyehet e modifikimit të Shtojzës 5: AK paraqitjen e të gjithë elementeve si Arsenik, Cadium, Krom, Mërkuri, Nikel, Plumbi, Antimoni, Seleni, të cilat duhet të vërtetohen nëpërmjet analizës toksikologjike të realizuar pranë Institutit të Shëndetit Publik.

Instituti i Shëndetit Publik kryen analizën toksikologjike vetëm për metalet: Plumb, Kadium, Krom, Nikel, Ngjyrën dhe erën, Klorin Aktiv. Metalet e tjera ky institucion nuk i kryen për arsye të mungesës së bazës materiale ashtu sikurse është cituar dhe tek analiza që ju kemi bashkangjitur. Po kështu edhe elementi "densiteti" ky institucion nuk e paraqet tek analiza toksikologjike e kryer. Po kështu për të njëjtin procedurë prokurimi me të njëjtin Objekt Prokurimi, KPP me Vendim 888/2022, Datë 14.09.2022, Nr Prot 1779/6, ndër të tjera është shprehur se:

KPP konstaton se referuar informacionit të ISHP lidhur me llojet e analizave toksikologjike që kryen, ky i fundit me shkresën nr. 1003/1 prot., datë 06.09.2022 me objekt "Kthim përgjigje kërkesës për informacion" bën me dije se ISHP analizon 7 nga 12 tregues të hipokloritit të natriumit të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor si në vijim: Pamja (ngjyra dhe era), Klori aktiv C12, Kadmium (Cd), Krom (Cr), Nikel (Ni), Plumb (Pb). Për sa i përket treguesëve të tjerë si: Densiteti,

Arseniku (As), Mërkuri (Hg), Antimoni (Sb), Seleni (Se), në kthim përgjigjen e ISHP-së rezulton se nuk kryhen analizat për këto tregues. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere dhe specifikime teknike në lidhje me artikujt objekt-prokurimi, por në çdo rast këto specifikime teknike dhe kritere duhet të jenë në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës që prokurohet, si dhe duhet të jenë të justifikuar teknikisht bazuar në fakte dhe prova konkrete, pasi vendosja e kritereve të pajustificuara shkakton kufizime dhe përjashtime tërësisht të panevojshme nga pjesëmarrja në procedurë e operatorëve ekonomikë të interesuar. Për sa më sipër KPP gjykon se autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë qartë bazuar edhe në përgjigjen e ISHP-së se për cilët tregues duhet të kërkojë analizën toksikologjike nga ana e ISHP dhe për analizat toksikologjike që nuk kryhen nga ISHP autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë organizmat ose institucionet konkrete private ose shtetërore të akredituar vendase ose të huaja të cilat mund të kryejnë këto lloj analizash toksikologjike. Gjithashtu në përcaktimin e këtyre organizmat ose institucionet konkrete private ose shtetërore të akredituar vendase ose të huaja autoriteti kontraktor duhet të mbështetet dhe në përvojën e viteve të mëparshme lidhur me realizimin e këtyre lloj analizash toksikologjike. Përsa më sipër KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin e sipërpërmendur, duke përcaktuar qartë organizmat ose institucionet konkrete private ose shtetërore të akredituar vendase ose të huaja që kanë kapacitete për kryerjen e këtyre lloj analizash toksikologjike.

Kerkojme: Modifikimin e këtij kriteri duke pranuar vetem elementet që kryen ISHP dhe modifikimin e Starnartiti S SH EN 937: 2016, ne po te atij starnarti që ISHP kryen. , si organi me i larte pergjegjes dhe Laboratori i vetem i akredituar ne Republikën e Shqipërisë për kryerjen e Analizave të Hipoklorit Natriumi.

Kriteri: 2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë në sistemin elektronik certifikatën e analizës nga Instituti i Shëndetit Publik ose nga laboratore të certifikuar , për analizë toksikologjike për produktin që prokurohet (certificate analize brenda 3 muajve të fundit).

Aresyet e modifikimit ose heqjes se këtij kriteri: Po për të njetin procedurë prokurimi me të njetin objekt prokurimi, KPP me Nr Vendimi 473/2023, Datë 06.06.2023, Nr Prot 963/9 është shprehur se: Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kritereve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin dhe natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me kriterin e vendosur. Referuar dokumentacionit të Procedurës së Prokurimit, vendosja e kërkesës jo më vonë se 60 ditë nga data e hapjes së procedurës së prokurimit, tek Kapaciteti teknik, pika 2.3.6 e kërkesës për fletë analizë toksikologjike ose deshmi të testimeve, nuk i shërben objektit të prokurimit, pasi në kthim përgjigjen e Institutit të Shëndetit Publik me nr. 513/1 prot., datë 26.05.2023, për kërkesën e bërë nga Komisioni i Prokurimit Publik me nr. 963/7 prot., datë 18.05.2023 mbi afatin ligjor të vlefshmërisë së një raporti analize, nga ky institucion është sqaruar se raporti i analizës në çdo rast është i vlefshëm vetëm për mostrën e sjellë në ISHP, cka është shënuar edhe në raportin e analizës. Për pasojë kjo kërkesë nuk është në përputhje me nenet përkatëse: nenet 40 dhe 77 të LPP-së dhe nenit 55 “Procedurë e hapur e thjeshtuar” të V.K.M-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku janë përcaktuar qartë kriteret e nevojshme në procedurat e prokurimit për kontratat e mallrave, përmbushja e të cilave i jep siguri Autoritetit Kontraktor, që operatorët ekonomikë janë në gjendje të realizojnë me sukses kontratën.

III.2.11. Sa më sipër, KPP vëren, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, se parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregullat, të hollësishme për të gjitha palët në proces.

III.2.12. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor ka hartuar

dokumentet e tenderit të mësipërm në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi për prokurimin publik. Komisioni i Prokurimit Publik thekson, se kriteret e kualifikimit duhet të përcaktohen qartë, saktë dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim që të mos rëndojnë mbi operatorët ekonomikë me kërkesa të tepërta dhe të panevojshme, por të fokusohen në ato kriteret, realizimi i të cilave jep një informacion mbi operatorët ekonomikë dhe siguri autoritetit kontraktor, me qëllimin final të përmbushjes me sukses të procedurës së prokurimit. Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se vendosja e kriterëve të veçanta të kualifikimit në kundërshtim me frymën e ligjit dhe akteve nënligjore në hartimin e 16 dokumenteve të procedurës së prokurimit, përbëjnë shkak për anulimin e procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

III.2.13. Bazuar në nenin 118, pika 2, gërma “b” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, sipas të cilit: “Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin; nenit 98, pika 1, gërma “d” të këtij ligji ku thuhet shprehimisht: “Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj”, si dhe në nenin 45, pika 1 gërma “b” të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: “[?]Komisioni i Prokurimit Publik në kuadër të veprimtarisë së shqyrtimit të ankesave para lidhjes së kontratës procedon me: b) Vendim për pranimin e ankesës dhe urdhërimin e autoritetit/entit kontraktor, që të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” [?]” Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kërkesa e parashikuar në pikën 2.3.6 “Kapaciteti teknik”, jo më vonë se 60 ditë nga data e hapjes së procedurës së prokurimit, për sa i përket kriterit për paraqitjen e fletë analizës toksikologjike ose deshmi të testeve, është një kërkesë e panevojshme, jo në përputhje me legjislacionin dhe rregullat e prokurimit publik, ndaj përbën shkak për anulimin e procedurës së prokurimit. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të anulojë procedurën e prokurimit dhe në rishpalljen e saj të mbajë në konsideratë parashikimet e këtij vendimi, duke hartuar kriteret për kualifikim, në përputhje me nevojat reale dhe përcaktimet e parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore të prokurimit publik.

Kerkojme: Modifikimin e këtij kriteri ashtu sic eshte kerkuar ne Vendimin e KPP.

5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme

Po

Jo

(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkoni)

6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

Nuk kemi

7. Lista e informacionit konfidencial:

Nuk kemi

Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes. □

Kujdes: Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit/Enti Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik**.

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

Nr. i faksit:

E-mail:

info@adchem.al

Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit

Administratori/Përfaqësuesi i autorizuar

Mamica Jançe